

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika® MonoSeal-101 H

LLAÇ ME BAZË ÇIMENTOJE DHE ME 1 PËRBËRËS PËR HIDROIZOLIM BETONI DHE MURESH



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika® MonoSeal-101 H është një miks çimentosh dhe agregatesh të posaçme me përbajtje aditivësh hidroizolues, që përzihet me ujë për të formuar një pastë e cila mund të aplikohet me furçë.

PËRDORIMET

Sika® MonoSeal-101 H është i përshtatshëm për hidroizolim të ngurtë mbi beton, mure dhe nënshtresa të suvatuara.

Është i përshtatshëm për hidroizolim në presion pozitiv dhe negativ. Disa shembuj tipikë të hidroizolimit me Sika® MonoSeal-101 H përfshijnë:

- Sipërfaqe të jashtme muresh që do të mbulohen me dhe
- Gropa ashensorësh
- Mure bazamentesh (të brendshëm)
- Rezervuarë dhe basene

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Hidroizolizim i efektshëm dhe me kosto të ulët i strukturave ekzistuese
- Aplikim i thjeshtë dhe i lehtë me furçë
- Rezistencë e lartë ndaj presionit pozitiv
- Rezistencë mesatare ndaj presionit negativ

- Ndërkapje e mirë mbi shumë nënshtresa përfshirë betonin, llaçet me bazë çimentoje, gurin, etj.
- Produkti i miratuar-certifikuar për kontaktin me ujin e pijshëm. Përputhet me kërkesat për cilësi të Ministrisë së Shëndetësisë së Francës, sipas udhëzimeve të Këshillit të Lartë të Shëndetit Publik në Francë, për sa i përket pajtueshmërisë së tij në kontakt me ujin e pijshëm.
- Certifikim CE

MIRATIME / STANDARDE

- Markë CE dhe Deklaratë Performance si produkt-veshje për mbrojtjen e sipërfaqes sipas EN 1504-2:2004, Parimi 2 (Kontroll i lagështisë) - Metoda 2.3 dhe Parimi 8 (Rritje e rezistencës) - Metoda 8.3 sipas EN1504-9:2008, bazuar në certifikatën e kontrollit të prodhimit në fabrikë të lëshuar nga organi i certifikimit të kontrollit të prodhimit në fabrikë dhe testimin e llojit.
- Certifikatë pajtueshmërie për kontaktin me ujin e pijshëm (pajtohet me rezultate pozitive të listës, CARSO-Departamenti i Shëndetit dhe Higjienës së Mjedisit të Lionit), data 29/07/2017, nr. i versionit 17 CLP LY 040 (gri).
- Në përputhje me specifikimet gjermane DWG 347 & W 320 për produktet në kontakt me ujin e pijshëm.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Çimento e modifikuar me polimere dhe agregate të përzgjedhura
Ambalazhi	thes 25 kg (gri)
Paraqitja / Ngjyra	Pluhur gri
Jetëgjatësia	12 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Produkti duhet të ruhet në ambalazhin original, në kushte të freskëta dhe të thata (+5°C dhe +35°C). Të mbrohet nga lagështia.

Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët (EN 1015-6) Gri: ~ 2.05 kg/L
Përmasa maksimale e kokrrizës	0.3 mm

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj ngjeshjes	1 ditë ≥ 10MPa	7 ditë ≥ 25MPa	28 ditë ≥ 35MPa	(EN 12190)
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	1 ditë ≥ 2 MPa	7 ditë ≥ 3 MPa	28 ditë ≥ 5 MPa	(EN 196-1)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	≥ 1.0 N/mm ²			(EN 1542)
Përshkueshmëria e avujve të ujit	Kategoria I, S _D < 5 m			(EN ISO 7783)
Absorbueshmëria kapilare	w < 0.1 kg/m ² ·h ^{0.5}			(EN 1062-3)
Depërtimi i ujit nën presion	Pa depërtim (1.5 bar / 3 ditë)			(EN 12390-08)

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	6.0 - 6.6 lt ujë për thes 25 kg (gri)		
Konsumimi	~ 1.5 kg/m ² /mm të trasësisë së shtresës		
Trashësia e shtresës	Trashësia max. është 2 mm		
Temperatura e mjedisit	+5°C min. / +35°C max.		
Koha e punueshmërisë	~ 60 minuta		
Koha e pritjes / mbiveshja	Koha e rekomanduar e pritjes midis veshjeve është 2 orë. Sika® MonoSeal-101 H duhet të ngurtësohet në mënyrën e duhur përpara mbiveshjes ose kontaktit me ujin. Si udhëzim:		
		+10°C	+20°C
	Zhytja në ujë	~ 7 ditë	~ 2 ditë

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

- Nënshtresa duhet të përgatitet me teknika të përshtatshme përgatitjeje mekanike, si uji me presion të lartë (400 bar), fërkim me furçë teli, kruarje e pllakave qeramike, rrymë uji në presion të lartë, etj.
- Smerilizoni dhe bluani pllakat ekzistuese, etj. për të hequr veshjet dhe bojërat ekzistuese, grason, ndryshkun, disarmentët, koren e çimentos (qumësht) dhe produkte të tjerat të cilat mund të reduktojnë ngjitjen.
- Pluhuri duhet të hiqet me vakuim elektrik.
- Nëse nevojitet, riparoni betonin e dëmtuar, shpetëzuar ose të dobët duke përdorur llaçet për riparim Sika MonoTop®, SikaRep®.
- Crumbullakosni të gjitha këndet ose profilet e mprehta (ndërlidhjet mur-dysheme, etj.), duke përdorur llaçet Sika MonoTop®, për të përmirësuar efikasitetin e aplikimit.
- Lagni nënshtresën deri në saturim. Të shmanget grumbullimi ose kondensimi i ujit mbi sipërfaqe përpara aplikimit (sipërfaqja duhet të ketë paraqitje mat të errët). Mos e aplikoni kurrë produktin në

prani të asnjë sasive uji të grumbulluar.

PËRZIERJA

Sika® MonoSeal-101 H mund të përzihet me mikser elektrik në shpejtësi të ulët (~ 500 r.p.m.), duke shtuar sasinë e saktë të ujit, sipas konsistencës së kërkuar. Pasi të jetë arritur një miks homogjen, vazhdoni përzierjen për 3-4 minuta. Llaçi duhet të jetë homogjen dhe kokrriza. Mos shtoni asgjë brenda miksit. Përzieni thasë të plotë, për të shmangur shpërndarjen e pabarabartë të grimcave dhe agregateve.

APLIKIMI

Llaçi mund të aplikohet me furçë. Veshja e parë e produktit duhet të depërtojë me kujdes tek nënshtresa e lagësht. Punoni me saktësi në skajet dhe qoshet. Në përgjithësi kërkohen 2 ose 3 shtresa. Shtresat e llaçit duhet të aplikohen një herë vertikalisht një herë horizontalisht (tërthorazi).

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të kryhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të

hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Për sa i përket fugave të mundshme subjekt i zhvendosjeve minimale dhe zona të tjera kritike (p.sh. ndërlidhja me sipërfaqet vertikale), shtresa hidroizoluese duhet të përforcohet me shiritin e posaçëm Sika® SealTape-S. Duhet të aplikohet mbi shtresën e parë të freskët dhe pastaj të mbulohet me shtresën e dytë.
- Për sa i përket fugave strukturore (subjekt i lëvizjeve të mëdha), është i detyrueshëm përdorimi i Sikadur®-Combiflex®-SG.
- Sika® MonoSeal-101 H nuk mund të aplikohet në temperatura nën +5°C (të mjedisit dhe nënshtresës).
- Sika® MonoSeal-101 H nuk mund të aplikohet për hidroizolimim e një nënshtrese me rrjedhje, sepse llaçi do të "shpëlahet" përpara ngurtësimit.
- Si të gjitha materialet hidraulike-me mpiksje, Sika® MonoSeal-101 H duhet të mbrohet nga avullimi i shpejtë.
- Sika® MonoSeal-101 H nuk mund të lyhet me bojë me bazë uji dhe as të suvatohet. Kur të nevojitet, lyeni me bojë me bazë tretësi.
- Produkti është i përshtatshëm për presion të lartë pozitiv uji dhe presion mesatar negativ uji.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika® MonoSeal-101 H
Qershor 2019, Botimi 04.01
020701010010000280

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaMonoSeal-101H-sq-AL-(06-2019)-4-1.pdf